



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.884/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Gyltene Sylejmani anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelet e parashtruara nga Lorentë Morina Vuthi, kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Istog nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara apelet e parashtruara nga Lorentë Morina Vuthi, kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Istog, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 10.11.2017 në ora 10:45, ka pranuar apelet: ZL.Anr.884/2017, ZL.Anr.885/2017 dhe ZL.Anr.886/2017, nga Lorentë Morina Vuthi, kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Istog, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me të cilët pretendon se në vendvotimet : 0620C/02R, 0613C/02D, 0608C/01R, 0608C/02D, 0601C/02R, 0606C/04R, 0602C/03R, 0606C/06D, 0620C/04D, 0620C/03R, i mungojnë votat e familjarëve dhe miqve dhe për këtë dyshon në numërimin dhe paraqitjen jo të saktë të votave në formularët e rezultateve.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.884/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për shtatë apelet që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmeris së apeleve dhe vlerësimit të shkresave në lëndë, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apelet janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apelueses gjeti se, apeluesja nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të dëshmuar pretendimet e saj ankimore. Prandaj Paneli apelin e ankueses e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se pretendimet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara dhe si të tilla apeli i ankuesit u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.884/2017 me datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.